



KUVENDI I SHQIPËRISË

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

Tiranë më, 10.6.2019

Dokument parlamentar

RAPORT PËR

PROJEKTLIGJIN “PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË MBRETËRISË SË ARABISË SAUDITE, PËR SHËRBIMET AJRORE”

- ***Hyrje***

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin, bazuar në nenet 32 - 38 të Rregullores së Kuvendit, në cilësinë e Komisionit përgjegjës, shqyrtoi projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Mbretërisë së Arabisë Saudite, për shërbimet ajrore”, në mbledhjen e tij të datës 10 qershor 2019.

Komisioni caktoi relator për këtë projektligj Zotin Ardit KONOMI.

Të pranishëm gjatë shqyrtimit të projektligjit ishin përfaqësues të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.

- ***Baza kushtetuese e projektligjit***

Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Mbretërisë së Arabisë Saudite, për shërbimet ajrore” është nismë e Këshillit të Ministrave dhe i paraqitet për shqyrtim Kuvendit mbështetur në nenet 78, 83, pika 1, dhe 121 pika 1 të Kushtetutës.

Miratimi i këtij projektligji kërkon një shumicë të thjeshtë votash, sipas nenit 55, pika 1 e Rregullores së Kuvendit.

- ***Qëllimi dhe përmbajtja e projektligjit***

Projektligji synon ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Mbretërisë së Arabisë Saudite, për shërbimet ajrore, e cila ka për qëllim rritjen e bashkëpunimit dypalësh në fushën e transportit ajror.

Marrëveshja pritet të ndikojë në krijimin e kushteve të përshtatshme, të ndërsjella dhe lehtësuese, për operatorët e transportit ajror të të dyja vendeve, si dhe kalimin tranzit nëpërmjet territoreve të tyre, me qëllim lëvizjen pa pengesa për shtetasit e të dyja palëve.

Detyrimi për këtë marrëveshje është koordinimi i veprimtarisë në fushën e aviacionit civil dhe rrjedh nga qenia palë e Konventës së Çikagos mbi Aviacionin Civil Ndërkombëtar.

Kjo marrëveshje pritet të ketë ndikim pozitiv në:

- Promovimin e një sistemi aviacioni ndërkombëtar bazuar në konkurrencën ndërmjet linjave ajrore në treg me ndërhyrje minimale të qeverive;
- Lehtësimin e zgjerimit të mundësive të shërbimeve ajrore ndërkombëtare;
- Bindjen që shërbimet ajrore ndërkombëtare konkurruese dhe efikase ndikojnë në rritjen e tregtisë dhe zhvillimin ekonomik;
- Garantimin e një shkalle më të lartë sigurie dhe mbrojtjeje të shërbimeve ajrore ndërkombëtare;

Bashkëpunimi në fushën e transportit ajror konsiston dhe orientohet nga parimi i krijimit të komunikimit ndërmjet vendeve, gjë e cila justifikon dhe iniciativën e nisur për të realizuar këtë marrëveshje, e cila krijon hapësira dhe mundësi më të mira për shtetasit e palëve kontraktuese për transport udhëtarësh, mallrash dhe dërgesash postare.

Marrëveshja ka disa aspekte kryesore të cilat janë dhënia e të drejtave, facilitetet dhe tarifat aeroportuale, parimet drejtuese të shërbimeve të miratuara, siguria ajrore, sigurimi i aviacionit, tarifat, etj.

Secila palë në këtë marrëveshje i jep palës tjetër të drejta të specifikuara me qëllim krijimin dhe kryerjen e shërbimeve ajrore ndërkombëtare të programuara për linjat në pikat e Republikës së Shqipërisë, pikat e ndërmjetme dhe në pikat e Arabisë Saudite të përcaktuara këto sipas Itinerarit bashkëlidhur kësaj marrëveshjeje.

Secila palë do të caktojë aeroportet në territorin e saj për përdorim nga linjat ajrore të përcaktuara të palës tjetër. Ajo do t'i sigurojë palës tjetër mjete transmetuese dhe meteorologjike si dhe shërbime të tjera të nevojshme.

Në pajtim me të drejtat dhe detyrimet e secilës palë, sipas së drejtës ndërkombëtare, nëpërmjet marrëveshjes riafirmohet detyrimi i palëve ndaj njëra – tjetrës për të mbrojtur sigurinë e aviacionit civil ndaj akteve të ndërhyrjeve të paligjshme, në përputhje me konventat ndërkombëtare për këtë qëllim dhe, veçanërisht, në pajtim me dispozitat e sigurisë së aviacionit që janë vendosur nga Organizata Ndërkombëtare e Aviacionit Civil.

Detyrimi i palëve për të mbrojtur sigurimin e aviacionit civil është pjesë e marrëveshjes. Sipas kërkesës palët do të jenë ndihmë e njëri tjetrit për të parandaluar aktet e sekuestrimit të paligjshëm dhe akteve të tjera të paligjshme ndaj sigurisë së avionëve, pasagjerëve, aeroporteve dhe pajisjeve të navigimit ajror.

- ***Vlerësimi i Ligjshmërisë Kushtetuese dhe harmonizimi me legjislacionin në fuqi dhe aktet ndërkombëtare.***

Projektligji është në përputhje me nenet 78, 83, pika 1, dhe 121 pika 1 të Kushtetutës, si dhe me ligjin nr.43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”.

Në aspektin procedural projektligji është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit.

Në aspektin formal projektligji përbëhet nga 2 nene.

- ***Diskutimi në komision***

Relatori i projektligjit vlerësoi krijimin e kushteve të përshtatshme, të ndërsjella dhe lehtësuese, për operatorët e transportit ajror të dyja vendeve që rrjedhin nga zbatimi i kësaj marrëveshje dhe lehtësimin e zgjerimit të mundësive të shërbimeve ajrore ndërkombëtare në përgjithësi.

Përfaqësuesit e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë shpjeguan elementët kryesor të kësaj marrëveshjeje dhe ndikimin që konsiderohet të ketë ajo në rritjen e bashkëpunimit dypalësh në fushën e transportit ajror, si dhe u shprehën për marrëveshje të tjera të ngjashme që ka lidhur Shqipëria në fushën e shërbimeve ajrore.

Diskutimet në Komision, u përqëndruan kryesisht në përfitimet që do të ketë vendi nga zbatimi i kësaj marrëveshjeje; facilitetet që do u ofrohen linjave ajrore ndërkombëtare të palës tjetër; të drejtat e palëve për kryerjen e shërbimeve ajrore ndërkombëtare të programuara kryerjen e shërbimeve ajrore ndërkombëtare të programuara; etj.

- ***Përfundim***

Komisioni vlerësoi marrëveshjen për lehtësimin e zgjerimit të mundësive të shërbimeve ajrore ndërkombëtare mes palëve dhe shprehu bindjen që shërbimet ajrore ndërkombëtare konkurruese dhe efikase ndikojnë në rritjen e tregtisë dhe zhvillimin ekonomik të vendeve.

Në përfundim të diskutimeve miratoi projektligjin në parim, nen për nen dhe në tërësi me të gjitha votat e anëtarëve të pranishëm dhe u shpreh dakord për kalimin e tij për miratim në seancë plenare.

Ardit KONOMI

Niko PELESHI

Relator

Kryetar